



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. .... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 26/ 07 / 2023

**VENDIM**

Nr. 22, date 26 /07/2023

**PËR**

**PLANET E GADISHMERISE NE RASTET E EMERGJENCAVE CIVILE PER DIGAT E SHFRYTEZUARA NGA BASHKIA DEVOLL**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 26.07.2023 mori në shqyrtim Planin e Gadishmerise ne rastet e emergjencave civile per digat e medha qe shfrytezohen nga Bashkia Devoll.

Planet e Gadishmerise ne rastet e emergjencave civile per digat e medha te pregatitur nga specialistët e Bashkise Devoll dhe dorëzuar pranë KKDM rezulton se nuk jane pregatitur ne perputhje me kerkesat e KKDM per hartimin e ketyre planeve te dhena ne Vendimin e KKDM Nr. 5, dt.16.11.2020. Plani I paraqitur eshte tip per te gjitha digat e kesaj bashkie ne nje kohe qe keto Plane duhet te pregatiten per cdo dige sipas specifikave te tyre dhe duhet te perfshijne 4 skenare te planit te veprimit ne rastet e emergjencave civile dhe harten e permbytjeve nga aktiviteti i shfrytezuesit te diges per zonen poshte saj

Keshilli Teknik i Perhershëm i Digave (KTPD) i rekomandoi antareve te KKDM të mos miratoj Planin e emergjencave civile te paraqitur nga Bashkia dhe ti kerkoj pregatitjen e ketij plani sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe Udhezuesit te KKDM te miratuar me Vendimin e mesiperm. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

**VENDOSI:**

- 1- Të mos miratoj Planin e Gadishmerise per rastet e emergjencave civile te digave të medha te shfrytëzuara nga Bashkia Devoll e paraqitur nga kjo Bashki për arsye të mosplotësimit të kërkesave të Vendimit të KKDM Nr. 5, datë 16.11.2020, mosparaqitjes se skenareve te planit te veprimit ne rastet e emergjencave civile si dhe dokumentacionin teknik te plote te kerkuar ne Udhezuesin perkates te KKDM.
- 2- Ti kërkoj Bashkise Devoll:
  - Përgatitjen dhe dorezimin per miratim prane KKDM te planit te Gadishmerise ne rastet e emergjencave civile per shkak te perdorimit te digave te medha te shfrytezuara nga Bashkia Devoll. Ky plan duhet të pregatitet sipas udhezimeve te dhena në Vendimin e KKDM Nr.5, date, 16.11.2020; Keto Plane duhet te dergohen per miratim perpara fillimit te sezonit te rreshjeve
  - Informacion në lidhje me digat qe ndodhen ne territorin e bashkise Devoll dhe qe jane aktualisht jasht funksionit si dhe Informacion ne lidhje me njerezit ne rrezik nga prishja e diges qe ndodhen ne zonat urbane poshte tyre. Ky informacion te dergohet brenda muajit Shtator 2023

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

